


“CONDOR” SH.P.K.
Miradi e Poshtme – Fushë Kosovë



**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR BAZËN E
PRODHIMIT TË BETONIT NGA KOMPANIA - “CONDOR” SH.P.K,
MIRADI E POSHTME, K. FUSHË KOSOVË**

Fushë Kosovë, Nëntor 2024

RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR BAZËN E PRODHIMIT TË BETONIT	
Në parcelat me numër: 00532-3, 00532-4, 00017-0, Zona Kadastrale - Miradi e Poshtme, Fushë Kosovë	
Invesitori	<u>“Condor” SH.P.K</u>
Pronari	<u>Bekim Thaqi</u>
Adresa	<u>Kramovik,p.n. 21000- Rahovec</u>
Lokacioni	<u>Fushë Kosovë</u>
Tel	<u>044-107-379, +383 (0) 44 444 186</u>
Email	<u>info@condorshpk-rks.com</u>

Hartuse e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis	
Emri	<u>Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari</u>
Email	<u>Blerinabajraktari1@gmail.com</u> <u>Blerinabajraktari3@gmail.com</u>
Tel.	<u>+383 49 588 634</u>
Nr. i Licencës	<u>07/20</u>

“CONDOR” SH.P.K

Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari

Nënshkrimi

Nënshkrimi

Fushë Kosovë, Nëntor 2024

PËRMBAJTJA:

1.	HYRJA.....	5
1.1.	Përshkrimi i projektit	6
1.2.	Vendndodhja e projektit	7
1.3.	Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit.....	9
1.4.	Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit	10
1.5.	Lënda e pare dhe lënda ndihmëse	12
2.	PËRSHKRIMI DETAL I PROCESIT TEKNOLOGJIK	12
2.1.	Deponimi i Agregatit.....	15
2.2.	Bunkerët e Agregatit	16
2.3.	Përgatitja e agregatit.....	16
2.4.	Transportieri i pjerrët i agregatit	16
2.5.	Mbushja e siloseve.....	17
2.6.	Transporti i çimentos (kërmillori) deri në përzierëse.....	17
2.7.	Përcaktimi i sasisë së çimentos	17
2.8.	Uji dhe rezervuarët e ujit të deponuar	17
2.9.	Rezervarët dhe pompat për aditivët e betonit.....	18
2.10.	Kompresori për ajrin e komprimuar.....	18
2.11.	Prodhimi i gatshëm (Beton i Freskët)	18
3.	PËRLLOGARITJA SIPAS LLOJIT DHE SASISË TË MBETJEVE DHE EMETIMEVE TË PRITURA GJATE FAZËS SË OPERIMIT.....	20
4.	KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së.....	22
5.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË ARSYESHME	22
6.	GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT	25
7.	IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	25
7.1.	Ndikimet në ajër.....	26
7.2.	Ndikimet në tokë.....	26
7.3.	Ndikimet në ujë.....	27
7.4.	Ndikimet në peizazh	28
7.5.	Ndikimet në Florë dhe Faunë.....	29
7.6.	Ndikimet në vendbanime dhe populate.....	29
7.7.	Ndikimet nga zhurma.....	29
7.8.	Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore.....	30

7.9.	Erozioni.....	30
8.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS	31
9.	PËRSHKRIMI I METODAVE PER VLERSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE	32
10.	PËRSHKRIMI I MASAVE.....	33
10.1.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	33
10.2.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë dhe në tokë	34
10.3.	Masat për mbrojtje nga zhurma	35
10.4.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë	35
10.5.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë	36
10.6.	Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore.....	36
10.7.	Menaxhimi i mbeturinave	36
11.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE	37
12.	MONITORIMI DHE RAPORTIMI.....	37
13.	PËRMBLEDHJE E PËRGJITHËSHME	38
14.	ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT NË FORMË TABELARE	39
15.	LITERATURA E PËRDORUR	40

LISTA E FIGURAVE

Figure 1.	Shtrirja hapësinore e Lokacionit të Bazës për prodhimin e Betonit "Condor" Sh.p.k.	7
Figure 2.	Lokacioni i bazës për prodhimin e betonit“Condor” Sh.p.k. nga Komuna e Fushë Kosovës	8
Figure 3.	Lokacioni i bazës se betonit me objektet për rreth	9
Figure 4.	Procesi teknologjik i Prodhimit të Betonit.....	13
Figure 5.	Procesi teknologjik i Punës së bazës për prodhimin e betonit.....	19

LISTA E TABELAVE

Table 1.	Tabela e vlerave të lejuara të zhurmës.....	29
Table 2.	Paraqitja e mbeturinave sipas katalogut shtretëror.....	36

1. HYRJA

Bazuar në nenin 11 dhe shtojcën 4 të Ligjit me nr. 08/L-181 për vlerësimin e ndikimit në mjedis, si dhe duke u bazuar në përmbushjen e kërkesave nga Inspektorati Mjedisor, kompania “Condor” SH.P.K nga Fushë Kosova ka filluar përgatitjen dhe kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e prodhimit të betonit, “Condor” SH.P.K është kompani e themeluar në muajin Nëntor të vitit 2006 për prodhimin e betonit, e cila ka ndërtuar bazen e re të prodhimit të betonit në parcelat me nr. 00532-3, 00532-4 dhe 00017-0 Z.K. Miradi e Poshtme të Komunës së Fushë Kosovës. Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për marrjen e Pëlqimit Mjedisor për Bazën e Prodhimit të Betonit, me qëllim që të identifikohen dhe analizohen ndikimet në mjedis nga ndërtimi i Bazës për prodhimin e betonit dhe të tërë veprimtarisë së sajë, duke i parashtruar dhe ndërmarr masat e domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit në lokacionin ku do të ushtrohet kjo veprimtari. Në raportin e VNM-s do të analizohen karakteristikat e gjendjes ekzistuese të mjedisit në lokacionin e bazës së betonit si dhe karakteristikat e potencialeve përkatëse, nga njëra anë, dhe karakteristikat inxhinieriko - teknike të punëve të cilat zhvillohen në bazë të projektit, nga ana tjetër, shtrohet nevoja për hartimin e Raportit të VNM-së ku do të përkufizohen të gjitha ndikimet relevante që mund të paraqiten në relacionin bazë për prodhimin e betonit dhe mjedis, duke mos anashkaluar edhe ndikimet kumulative në regjionin më të gjerë. Duke u nisur nga qëllimi paraprak dhe në metodologjinë e hartimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ky Raport bëhet me qëllim të përkufizimit të ndikimeve potenciale dhe caktimin e masave të cilat do të jenë të nevojshme për tu marr për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative. Me hartimin e Raportit të VNM -së janë marrë për bazë ndikimet në mjedis dhe aplikimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve gjatë realizimit të ngritjes së bazës për prodhimin e betonit si dhe pas përfundimit të projektit. Ndërtimi i bazës për prodhimin nga kompania “Condor” SH.P.K është bërë në parcelat me nr. 00532-3, 00532-4 dhe 00017-0 zona kadastrale Miradi e Poshtme, Fushë Kosovë.

1.1. Përshkrimi i projektit

Ky projekt do të përfshijë detalet e komponentëve, proceseve dhe pajisjeve kryesore të përdorura për prodhimin e betonit në një mënyrë sistematike dhe efektive. Betonjerka e ndërtuar për kompaninë “Condor” SH.P.K është një strukturë moderne dhe e avancuar, e projektuar për të përmbushur standardet më të larta të cilësisë dhe efikasitetit në prodhimin e betonit. Vendndodhja e lokacionit të planifikuar të bazës së betonit është përzgjedhur sepse është në afërsi të rrugës Industriale. Afër bazës së prodhimit të betonit, ka shumë biznese tjera të cilat veprojnë në afërsi të lokacionit të planifikuar ku është vendosur baza për prodhimin e betonit. Përparësi e këtij lokacioni është se ka energji elektrike të qëndrueshme e cila është njëra ndër komponentët kryesore si gjatë ndërtimit e po ashtu edhe gjatë funksionalizimit të bazës për prodhimin e betonit si dhe ka sasi të mjaftueshme të ujerave nëntokësorë të cilat janë lëndët kryesore që përdoren tek prodhimi i betonit dhe mirëmbajtja e ambientit, ndërsa lëndet tjera të para si zhavorri në fraksione, rëra, çimento dhe aditivët (nëse përdoren) këto përpunohen dhe deponohen tek baza e betonit.

Baza e prodhimit përbëhet nga:

- Bunkerët Pranues të Rërës dhe Zhavorrit
- Dozatorët Pneumatik
- Peshoret Automatike për Matjen e Materialeve
- Pompat dhe Furnizimi me Ujë
- Ujmatesi për Sasinë e Matjes së Ujit
- Shiritat Transportues Furnizues
- Përzierësit e Betonit – Mikserët
- Siloset e Çimentos me Filtraventilues
- Transportuesit me Vidhë
- Kabina Komanduese
- Kompresori për Furnizim me Ajër për Pajisjet Pneumatike
- Furnizimi me Energji Elektrike

Pas prodhimit të betonit në mikserin e përzierjes së lëndeve të para e cila kontrollohet nga stafi i specializuar për këtë lëmi, bëhet ruajtja e betonit të sapo përzier siç janë kamionët special transportues, ku para se të shkarkohet në këta kamion bëhet testimi i betonit të freskës se a është sipas klasës/Markës së kërkuar. Orari i punës është në këtë bazë betoni është nga ora 08:00 – 16:00

sipas nevojës mund të kërkohej që të vazhdohej edhe më shumë për arsye të mos ndërprerjes së prodhimit të betonit. Në fund të çdo orari të punës bëhet pastrimi i makinerive dhe përgatiten për ditën e ardhshme për punë më të mirë. Duke u bazuar në kërkesat të cilat dalin Ligji i ndërtimit, ku njëra ndër kushtet është edhe Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për tu pajisur me Pëlqim Mjedisor, kompania “Condor” SH.P.K., ka angazhuar personë fizik të licencuar për Hartimin dhe përgatitjen e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Bazën e Prodhimit të betonit me lokacion në Miradi e poshtme komuna e Fushë Kosovës. Ky raport është hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca 4. po ashtu qëllimi kryesor i këtij raporti të VNM-së është identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis me qëllim të ndërmarrjes së masave të nevojshme për ti minimizuar ndikimet negative në Mjedis gjatë ndërtimit e po ashtu edhe gjatë operimit.

1.2. Vendndodhja e projektit

Objekti i Bazës së prodhimit të betonit me të gjitha objektet përcjellëse është vendosur në ngastrat kadastrale me nr. 00532-3, 00532-4 dhe 00017-0 zona kadastrale Miradi e Poshtme, Fushë Kosovë e cila gjendet në afërsi të rrugës “Peja”.




Figure 1. Shtrirja hapësinore e Lokacionit të Bazës për prodhimin e Betonit "Condor" Sh.p.k.




Figure 2. Lokacioni i bazës për prodhimin e betonit “Condor” Sh.p.k. nga Komuna e Fushë Kosovës

Në afërsi të lokacionit ku është ndërtuar baza për prodhimin e betonit nga kompania “Condor” SH.P.K. nuk ka shtëpi afër, shtëpitë më të afërta janë në distance 435.59metra, ndërsa në afërsi të parcelës gjenden disa biznese tjera me veprimtari të ndryshme.



Figure 3. Lokacioni i bazës së betonit me objektet për rreth

1.3. Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit

Baza për prodhimin e betonit përbehet si ne vijim:

- Bunkerët Pranues të Rërës dhe Zhavorrit - (Ruajtja e materialeve të grira si rëra dhe zhavorri, që janë përbërës të rëndësishëm në përzierjen e betonit)
-
- Dozatorët Pneumatik - (Kontrolli i saktë i sasisë së materialeve të para që do të dërgohen në përzierës)
- Peshoret Automatike për Matjen e Materialeve - (Matja e saktë e materialeve të grira dhe çimentos për të siguruar përzierjen e duhur)
- Pompat dhe Furnizimi me Ujë - (Furnizimi i përzierësve me sasinë e nevojshme të ujit për të përzier betonin)
- Ujematesi për Sasinë e Matjes së Ujit - (Matja e saktë e sasive të ujit që do të përdoren në përzierje)

- Shiritat Transportues Furnizues - (Transportimi i materialeve të grira dhe çimentos nga bunkerët në mikserë ose në zona të tjera të bazës)
- Përzierësit e Betonit – Mikserët - (Përzierja e materialeve të ndryshme për të krijuar betonin e gatshëm për përdorim)
- Siloset e Çimentos me Filtraventilues - (Ruajtja e çimentos dhe mbrojtja nga ndotja dhe humbja e pluhurit)
- Transportuesit me Vidhë - (Transportimi i materialeve të ndryshme, si çimento dhe rërë, nga një pikë në tjetrën brenda bazës së prodhimit)
- Kabina Komanduese - (Menaxhimi dhe kontrolli i të gjitha operacioneve të bazës së prodhimit)
- Kompresori për Furnizim me Ajër për Pajisjet Pneumatike - (Furnizimi me ajër të kompresuar për pajisjet që përdorin teknologji pneumatike)
- Furnizimi me Energji Elektrike - (Sigurimi i energjisë elektrike për të gjitha pajisjet dhe sistemet e bazës së prodhimit)

1.4. Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit

Betoni me lëndë lidhëse inorganike paraqet në vetvete materialin prej guri artificial apo natyral, të prodhuar si rezultat i përzierjes dhe ngurtësimit të lëndëve lidhëse, çimentos, ujit, mbushësve (në këtë rast rërës dhe zhavorit), si dhe shtesave të veçanta të marra në raporte të caktuara (aditivët). Kërkesat për një cilësi të mirë të betonit në një kohë të shkurtër ka shtyrë në industrializimin e procesit dhe për rrjedhojë krijimin e impianteve të veçanta të prodhimit. Në vitet e 50-ta lindën impiantet e para lëvizëse të prodhimit në kantiere, dhe në vitet e 60-ta, si rrjedhojë e kërkesave të mëdha në rritje të sektorëve të ndërtimit, lindën shoqëritë e para të specializuara në prodhimin e betoneve në mënyrë të përqëndruar. Përdorimi i impianteve të përqëndruara lejon furnizimin e betonit me karakteristika konstante, me cilësi të produktit final më të mirë dhe i garantuar edhe nga pikpamja e kontrollit të cilësisë. Faza operative e një baze prodhimi betoni përfshin aktivitetet dhe proceset e përditshme të nevojshme për të prodhuar beton në mënyrë efikase dhe efektive.

Karakteristikat e fazes operative janë:

- Përbërja dhe Përzierja

Materialet kryesore përfshijnë çimento, aggregate (rëra dhe zhavorri), ujë dhe aditivë të mundshëm. Grumbullimi dhe matja e saktë e këtyre materialeve janë thelbësore për të siguruar cilësinë e

betonit. Përzierja e materialeve ndjek një formulë të dizajnuar për të arritur vetitë e dëshiruara të betonit, si forcën dhe qëndrueshmërinë. Saktësia në matjen dhe përzierjen e materialeve është kritike për performancën e betonit.

➤ Funksionimi i Pajisjeve

Pajisjet për grumbullimin e materialeve, mikserët, transportuesit dhe kamionët mikserë janë të rëndësishëm për procesin e prodhimit. Pajisjet duhet të mirëmbahen dhe operohen në mënyrë efikase për të siguruar prodhim të qëndrueshëm dhe cilësi të lartë të betonit.

➤ Kontrolli i Cilësisë

Betonit i nënshtrohet testeve të ndryshme si rrëshqitja, qëndrueshmëria në shtypje dhe punueshmëria për të siguruar që përmbush specifikimet e projektimit dhe standardet e industrisë. Monitorimi i përzierjes dhe cilësisë për të siguruar që çdo grumbull beton të ketë karakteristikat e kërkuara.

➤ Masat e Sigurisë

Sigurimi i pajisjeve të përshtatshme mbrojtëse personale për punëtorët. Zbatimi i procedurave të sigurisë dhe kryerja e trajnimeve të rregullta për punëtorët për të minimizuar rrezikun e aksidenteve.

➤ Pajtuueshmëria Mjedisore

Menaxhimi i mbetjeve dhe rrjedhjeve për të parandaluar ndotjen e tokës dhe ujit. Implementimi i masave për të reduktuar ndikimin mjedisor të procesit të prodhimit, duke ruajtur biodiversitetin dhe minimizuar ndotjen.

➤ Menaxhimi i Inventarit

Mbajtja e niveleve të çimentos, aggregateve dhe furnizimeve të tjera për të shmangur mungesat ose mbingarkesat. Sigurimi i një furnizimi të vazhdueshëm për të ruajtur efikasitetin e prodhimit.

➤ Efikasiteti i Energjisë

Implementimi i praktikave dhe pajisjeve me efikasitet energjetik për të kursyer kostot dhe për të reduktuar gjurmën e karbonit. Monitorimi dhe përmirësimi i përdorimit të energjisë për të reduktuar ndikimin mjedisor dhe kostot operacionale.

➤ Mirëmbajtja dhe Riparimet

Kryerja e mirëmbajtjes së planifikuar për të mbajtur pajisjet në gjendje të mirë pune dhe për të parandaluar defektet. Trajtimi i defekteve dhe riparimet e menjëhershme për të siguruar vazhdimësinë e prodhimit.

➤ Dorëzimi i Betonit

Sigurimi i dorëzimit të betonit në kohë dhe në përputhje me kërkesat e kantierit të ndërtimit. Përdorimi i kamionëve të betonit, pompave dhe metodave të tjera për transportimin e betonit në vendin e ndërtimit.

➤ Mbajtja e të Dhënave

Mbajtja e të dhënave të sakta për prodhimin e betonit, kontrollet e cilësisë dhe mirëmbajtjen e pajisjeve. Sigurimi i llogaridhënies dhe përmbushjes së kërkesave rregullatore përmes regjistrimeve dhe raportimeve të sakta.

➤ Përmirësimi i Vazhdueshëm

Rishikimi dhe përmirësimi i proceseve të prodhimit për të rritur efikasitetin dhe për të ulur kostot. Nxitja e një kulture të përmirësimit të vazhdueshëm në organizatë për të përmirësuar performancën dhe produktivitetin.

➤ Pajtueshmëria me Standardet

Sigurimi që betoni të plotësojë specifikimet e kërkuara për projekte të ndryshme ndërtimi. Përputhja me kodet lokale dhe rregulloret për ndërtimin dhe përdorimin e betonit.

1.5. Lënda e pare dhe lënda ndihmëse

Lëndët e para të prodhimit të betonit janë:

- Çimento,
- Agregati,
- Uji dhe
- Aditiviet here pas here

Lëndët kryesore për funksionimin e bazës së betonit:

- Energjia elektrike,

2. PËRSHKRIMI DETAL I PROCESIT TEKNOLOGJIK

Betoni përzihet me qëllim që brumi i çimentos të veshë kokërrizat e materialit mbushës dhe të shpërndajë përbërësit e tij në një masë të njëtrajtëshme. Kjo njëtrajtëshmëri nuk duhet të priset, kur betoni shkarkohet nga betoniera. Kapaciteti maksimal për prodhimin e betonit të freskët është

~ 70-80 [m³/h] dhe fillon me përgatitjen e materialeve si rëra dhe zhavori, çimento, uji dhe aditivet (nëse është i nevojshëm përdorimi i tyre). Prodhimi i betonit në betonuare fillon me përgatitjen e lëndëve të para: agregatit (fraksioneve të gurit apo fraksioneve të rërës), çimentos dhe ujit. Betonierat janë të tipeve me përmbysje dhe me veprim të detyruar. Në rastin e betonierës “Condor”, përzierëset-Automikserët janë me veprim të detyruar. Në këtë betonierë përzierja e betonit përcillet në kazanin e përzierëses, boshtet horizontale të së cilës rrotullohen së bashku me boshtet e lopatave përzierëse. Lëvizja relative në mes lopatave dhe betonit është e njëjtë dhe i gjithë betoni në kazan përzihet mirë. Për prodhimin e betonit të zakonshëm përdoret çimento portland dhe lloje të ndryshme të saj, si dhe lidhësit e tjerë që u përgjigjen kërkesave teknike dhe standardeve. Marka ose klasa e çimentos përcaktohet në varësi të markës apo klasës së betonit të projektuar në shtypje, në përgjithësi rezistenca e çimentos: $R_c = 1$ deri 2,5 herë marka e betonit. Lloji i çimentos duhet të caktohet në varësi të rëndësisë së konstruksionit dhe kushteve të shfrytëzimit të tij, të klasës së kërkuar të betonit.

Procesi teknologjik i prodhimit të betonit të freskët ka këtë rrjedhë:




Figure 4. Procesi teknologjik i Prodhimit të Betonit

Procesi teknologjik për prodhimin e betonit, në impiantin kapaciteti i të cilit do të jetë i paraparë, për 60-70 m³/h beton të freskët, fillon me përgatitjen e materialeve si rëra dhe zhavori, çimento,

uji dhe aditivët (nëse është i nevojshëm përdorimi i tyre). Kështu operacionet do të fillojnë nga mbushja e hinkave me rërë dhe zhavor. Mbushja e hinkave me rërë dhe zhavor sipas granulimeve, bëhet me anë të ngarkuesit në varshmëri nga teknologjia e markës së betonit që kërkohet të fitohet si produkt. Të gjitha deponitë e granulacioneve janë të ndara. Hapja e fortinave-bunkerëve (poz.1) apo shkarkimi i tyre, bëhet në mënyrë automatike në fund të të cilave gjendet dozatori dhe peshorja. Hapja e fortinave të dozatorëve të caktuar, është e programuar në mënyrë automatike në varshmëri nga granulimi i agregatit që kërkohet për tipin dhe markën e betonit. Për çdo tip apo markë betoni procesi teknologjik është i programuar dhe menaxhohet në mënyrë kompjuterike. Projekti i këtij sistemi, me lëshuarje në punë të tërë linjës teknologjike mundëson plotësisht menaxhimin kompjuterik të tërë procesit teknologjik të prodhimit të betonit. Në tërësinë e impiantit për prodhimin e betonit bëjnë pjesë edhe pajimet për furnizim me ujë, pajimet pneumatike, elektrike të cilat funksionojnë si tërësi automatike. Nga fortina agregati i përcaktuar apo i zgjedhur nga receptura e kërkuar, përmes dozatorit bie në transporterin shiritor përmbledhës me peshojë, mandej në transporterin shiritor të pjerrët dhe nga aty materiali mbushës hidhet përmes hinkës në përzierëset e betonit. Përbërësit tjerë të konglomeratit për beton si çimento që vie nga silosët nëpërmjet transporterëve me vidhë nga këtu hudhet në peshoren e çimentos dhe po i njëjti, në masën e caktuar sipas parametrave, përmes transporterit tjetër kërmillor hidhet në hinkën e përzierseve (mikserëve). Si operacion tjetër, që nënkupton përgatitjen, do të ishte të ushqyerit e silosit me çimenton e markës dhe tipit të paraparë. Të ushqyerit e silosit do të bëhet përmes kamionit-cisternë me ndihmën e pajisjeve pneumatike. Të ngarkuarit e siloseve gjegjësisht deponimi i çimentos bëhet me hapjen e valvualve përkatëse dhe përmes tubave, me shtytje pneumatike hudhet në brendi të siloseve. Funkzioni i siloseve është i kontrolluar si mbushja dhe zbrazja përmes niveluesit me sinjalizim si dhe sistem alarmi. Mbi silose, janë të vendosur euro-filtrat si dhe tubat pneumatik të cilët veprojnë tek siloset. **Euro-filtrat janë të prodhimit italian** dhe shërbenjë për pastrimin e ajrit që del nga silosët gjatë mbushjes së tyre nga autocisterna dhe punës kontinuale të tyre për furnizimin e mikserëve (përzierseve) me çimento. Që të zhvillohet procesi i përfitimit të betonit si komponentë lidhëse mbetet ardhja apo dozimi i ujit dhe komponentëve tjerë si aditivët të cilat shtohen në varshmëri nga tipi i betonit dhe kushteve tjerë që kërkohen në implementimin e betonit. Sasia e ujit bëhet po ashtu me dozim nga pompa për furnizim me ujë dhe ujëmatësi, i cili bënë matjen e saktë të sasisë së ujit të nevojshëm për përfitimin e markës së betonit. Ky do të ishte një përshkrim i shkurtër i lëvizjes së materialeve në skemën teknologjike për

prodhimin e betonit. Teknologjia e prodhimit të betonit kërkon që gjatë ngarkimit të përzierseve me aregate, së pari nga fortinat lëshohet rëra me granulim më të vogël, pastaj çimento dhe më pastaj zhavori. Se çfarë përzierje gjegjësisht konglomerati do të fitohet, mund të themi se komponentët futen në këto raporte të përafërta të dhëna në përqindje:

- agregat 78 %,
- çimento 13 % dhe
- mbetja ujë si dhe aditivët që shtohen në përmasa të caktuara.

Ndër aditivët, që jipen në varshmëri të kualitetit, është aditivi kur kemi të bëjmë me sanimin e betonit tek i cili kërkohet të shpejtuarit e kohës së ngurtësimit apo fortësisë e që në veçanti është si imperativ për prodhimin e betonit dhe implementimit të tij gjatë kohës së dimrit dhe aplikimit të tij tek konstruksionet e ndryshme të betonit. Lidhur me këtë preferohet aditivi BETONEL KK apo të njëjtë, më ngjyrë të verdhë në të çelët që bazën e ka në klorure. Dhënia e kësaj shtese preferohet tek rastet kur kemi të bëjmë me fabrikimin e elementeve të betonit gjatë dimrit. Në temperaturë pune të ambientit -8 °C dhe në rastet tjera kur kërkohet ngurtësimi i shpejtë, BETONEL KK jipet në betonin e freskët, në atë mënyrë duke shpejtuar procesin kimik të hidratimit të çimentos dhe në këtë formë shpejton procesin e arritjes së fortësisë. Aditivi zakonisht jipet në ujë të përzier apo mikser, ashtu që shpërndarja e tij të jetë e njëtrajtshme. Dozimi i kësaj shtese do të jetë: 2 – 4 % të masës së çimentos (2 deri në 4 kg në 100 kg çimento), në varshmëri nga përdorimi dhe kushtet e implementimit në konstruksione.

2.1. Deponimi i Agregatit

Deponimi i agregatit është një hap i rëndësishëm në procesin e prodhimit të betonit, pasi kjo ndihmon në ruajtjen e cilësisë dhe efikasitetit të përzierjes. Agregati i granulateve të ndryshme sillet me kamionë ose me lugë ngarkuese deri në hapësirën për deponim të agregatit në Fabrikën e Betonit. Kamionët për transportin e agregateve janë të pajisur me karakulle ose me kasë për të ruajtur materialin në kushte të mira dhe për të parandaluar ndotjen dhe humbjen e materialit. Agregatet janë të mbuluara për të mbrojtur nga faktorët e jashtëm si reshjet e shiut ose ndotësit e tjerë gjatë transportit. Lugët ngarkuese përdoren për të ngarkuar agregatet nga vendi i grumbullimit dhe për t'i transportuar ato në hapësirën për deponim në fabrikë.

2.2. Bunkerët e Agregatit

Procesi teknologjik për prodhimin e betonit, fillon me mbushjen e siloseve me rërë apo gur me granulacione të ndryshme në varësi të markës së betonit që dëshirohet të prodhohet, siloset pranues me fraksione të gurit ose rërës mbushen me anë të lugës ngarkuese nga depoja e fraksioneve të agregatit, katër siloset me fraksione të gurit ose rërës, janë të ndara njëra prej tjetrës me mure të pllakave të çelikut, **5 copë**.

2.3. Përgatitja e agregatit

Nga bunkerët e agregatit përmes dozatorit bëhet zbrazja e agregatit përmes mbyllësve që komandohen përmes pistonave pneumatik. Nga bunkerët e agregatit, agregati përmes transportierit horizontal mbledhës – Dozatorit bartet në Transportierin e Pjerrët Furnizues të Agregatit ku me pas agregatin e gatshëm e dorëzon në përzierësen e Betonit – Mikserit. Hapja e fortinave të dozatorëve të caktuar, është e programuar në varësi nga granulati i agregatit që kërkohet për tipin dhe markën e betonit. Për çdo tip apo markë betoni procesi teknologjik është i programuar dhe menaxhohet nga kabina komandues. Projekti i këtij sistemi, me lëshuarje në punë të tërë linjës teknologjike mundëson plotësisht menaxhimin automatik të tërë procesit teknologjik të prodhimit të betonit. Përbërësit tjerë të konglomeratit për beton si çimento që vije nga siloset e çimentos nëpërmjet transportierëve kërmillor hidhët në dozatorin e çimentos dhe po i njëjti, në masën e caktuar sipas parametrave bie në mikserin e caktuar i të cilit është 1.5 [m³]. Agregati nga të katër bunkerët në dalje të cilëve ndodhën dozuesit elektro - pneumatik të cilët me dhënien e komandës nga tabela komanduese hapen dhe mbyllen në mënyrë automatike pasi ta lëshojnë sasinë e caktuar të agregatit në shiritin transportues që ndodhet nën siloset e agregatit i cili i transporton granulacionet (fraksionet) e agregatit gjatë transportierit të pjerrët furnizues të agregatit - nën e cila nevojitet për bartjen e fraksioneve të agregatit gjatë mikserit (përzierëse) për prodhimin e betonit. Në dozuesit e fraksioneve më të imta janë të vendosur vibruesit me qëllim të rrjedhjes së fraksioneve sa më lehtë në nënën e agregatit.

2.4. Transportieri i pjerrët i agregatit

Nëpërmjet transportierit horizontal furnizues – Dozatorit respektivisht transportierit të pjerrët të agregatit, agregati i përgatitur transportohet dhe hidhet në përzierësen e betonit – Mikser.

2.5. Mbushja e siloseve

Mbushja e silosit (rezervuarit) të çimentos bëhet me auto-cisternë me ndihmën e pajisjeve pneumatike. Mbi siloset, janë të vendosur Euro-filtrat si dhe tubat pneumatik të cilët veprojnë tek siloset. Euro-filtrat janë të prodhimit italian dhe shërbejnë për pastrimin e ajrit nga pluhuri që del nga siloset gjatë mbushjes së tyre nga auto-cisterna dhe punës kontinuale të tyre për furnizimin e përzierës me çimento. Të ngarkuarit e silosit (Poz. 05), gjegjësisht deponimi i çimentos bëhet me hapjen e valvualve përkatëse (V1, V2) dhe përmes tubave (T1, T2), me shtytje pneumatike (Sh1, Sh2) dhe hedhet në brendi të silosit. Funkcioni i mbushjes dhe zbrazjes së silosit është i kontrolluar përmes niveluesit (N1, N2) me sinjalizim si dhe sistem alarmi.

2.6. Transporti i çimentos (kërmillori) deri në përzierëse

Transporti i çimentos nga silosat e deri në përzierësen e betonit - mikser behët përmes dy kërmilloreve. Dozimi i çimentos në përzierës bëhet nëpërmes transportuesit kërmillor nga silosi. Çimentoja me ramje të lirë bien në transportuesin të vendosur nën silos, pasandaj nëpërmjet transportuesit kërmillor dozohet në enën e peshojës për çimento. Zbrazja e enës së peshojës kryhet në mënyrë të programuar dhe atë në kohën e dozimit të agregatit në mikser (përzierëse). Ashtu që zbrazja e pajisjes për dozim të çimentos në mikser (përzierës) fillon automatikisht në momentin e fillimit të dozimit të agregatit nga ena në mikser (përzierës), apo disa sekonda më vonë. Gjatë kohës së zbrazjes së enës së peshojës me çimento duhet të lëshohet vibruesi, kur procesi kryhet në mënyrë manuele, kur procesi kryhet në mënyrë automatike vibruesi lëshohet në mënyrë automatike.

2.7. Përcaktimi i sasisë së çimentos

Përcaktimi i sasisë së çimentos bëhet me anën e peshores matëse në vartësi nga lloji i recepturës së betonit të freskët.

2.8. Uji dhe rezervuarët e ujit të deponuar

Uji për furnizim të përzierës - mikserit sigurohet nga pusi nëntokësor - bunari të hapura në këtë Bazë të Betonit dhe me pas uji akumulohet në rezervuarët e ujit 10 000 [litra] respektivisht në peshoren automatike. Dozimi i ujit në përzierës si lëndë e parë bazë për përfitim të betonit bëhet me dozimin e programuar nga pompa për furnizim me ujë kryhet gjithashtu në mënyrë automatike me fillimin e dozimit të çimentos. Pas dozimit të sasisë së caktuar të ujit, ventili dozues

automatiksht mbyllet. Nëse janë përmbushë kushtet e procesit për punë automatike (sasia e nevojshme e agregatit në fortin, shtypja e ujit duhet të jetë min. 3 [at] dhe sasia e nevojshme e çimentos), sasia e prodhuar e betonit për një cikël është 1.0 [m³], zgjatja e një cikli është përafërsisht 60 [s] në varshmëri të llojit të betonit. Gjatë kryerjes së procesit në mënyrë manuele koha e zgjatjes së ciklit varët nga aftësia e punëtorit që operon me pajimet për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit.

2.9. Rezervarët dhe pompat për aditivët e betonit

Që të zhvillohet procesi i përfitimit të betonit si komponentë lidhëse mbetet ardhja apo dozimi i ujit dhe komponentëve tjerë si aditivët të cilat shtohen në varësi nga tipi i betonit dhe kushteve tjerë që kërkohen në implementimin e betonit. Sasia e ujit bëhet po ashtu me dozim nga dozatori dhe pompa për furnizim me ujë.

2.10. Kompresori për ajrin e komprimuar

Procesi i mbylljes së dozatorëve të agregatit, dhe pajisjeve tjerë përcjellëse në Fabrikën e Betonit, realizohet përmes pistonave pneumatike që furnizohen me ajër të komprimuar nga kompresori pistonik.

2.11. Prodhimi i gatshëm (Betoni i Freskët)

Prodhimi i gatshëm (betoni i freskët) nëpërmjet hinkës zbrazet nga fundi i përzierëses në autopërzierëset dhe me pas bartet te klienti.




Figure 5. Procesi teknologjik i Punës së bazës për prodhimin e betonit

3. PËRLLLOGARITJA SIPAS LLOJIT DHE SASISË TË MBETJEVE DHE EMETIMEVE TË PRITURA GJATE FAZËS SË OPERIMIT

Për të përshkruar të gjitha emetimet e pritura dhe ndikimet e tjera gjatë fazës së operimit të bazës së prodhimit të betonit “Condor” SH.P.K, mund të shqyrtoni disa aspekte kyçe që ndërlidhen me mjedisin dhe shoqërinë.

Në ajër: Nga ky aktivitet kemi ndotje në kufij të lejuar nga pluhuri gjate mbushjes së bunkerëve, nga lëvizja e makinerive në sipërfaqet manipuluese si dhe në raste të përdorimit të makinerive të vjetra mund të ndodhë që lrimi i gazrave të ndikoj në ajër. Ndikime minimale në ajër, ndodhin, gjatë sjelljes së materialeve ndërtimore me kamion si dhe gjatë lëvizjes së mikserëve por janë ndikime të cilat mund të kontrollohen lehtë.

Në tokë: Duke konsideruar kapacitetet e projektuara të bazës së betonit, kanalet si dhe si rezultat i investimit adekuat në makineri të reja nuk do të kemi ndikime të mëdha në dhe ndërsa ujërat sipërfaqësore largohen në mënyrë të kontrolluar dhe se nuk shkarkohen në ujera nëntokësore, ku një pjese e tyre largohen në mënyrë natyrore ndërsa një pjese tjetër do të trajtohet në sedimentues dhe përsëri do të merret për shfrytëzim dhe mund të konstatohet se ndikimet në kualitetin e dheut dhe nën të janë minimale.

Në ujë: Kualiteti i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga aktiviteti i punës së bazës së Betonit nuk do të ndikoj negativisht, por duke u bazuar në masat e marrura nga kompania, nuk do të ndikoj negativisht gjatë fazës së operimit, ndotja është minimale. Shfrytëzimi i ujit do të përdoret për proces teknologjik të prodhimit të betonit si lëndë e parë por njëkohësisht do të përdoret edhe për pastrimin e makinerive, nevojat sanitare e higjienike të administratës si dhe ujitjen e sipërfaqeve manipuluese gjate kohërave të thata dhe shumë të nxehta për ndalimin e ngritjes së pluhurave në ajër. Shfrytëzimi i ujit i cili përdoret për nevoja teknologjike nuk shkarkohet sepse është njëra nga lëndet e para të prodhimit ndërsa nga pastrimi i makinerive do të shkarkohet në sedimentuesin për trajtimin e ujerave dhe pas trajtimit do të përdoret për pastrim të rrugëve ndërsa ujërat e shkarkuara nga punëtoret do të shkarkohen në rrjetin e kanalizimit të fshatit. Ndikimi kryesor i ndotjes së ujerave janë shkarkimet e ujerave të pa trajtuara në mungesë të impianteve por në rastin në fjale projektuesi ka parapare trajtimin e ujerave të ndotura nga e gjithë kompania.

Zhurma: gjatë operimit mund të ketë zhurmë gjatë lëvizjes së makinerive e cila është e pranueshme sipas normave, po ashtu edhe gjatë operimit është minimale.

Dridhjet: Territori i komunës së Fushë Kosovës i takon Zonës së IV-të të presionit (goditjes sizmike), 6-7 gradë në bazë të "MSC". Nuk ka të dhëna për mikro-zonat sizmike.

Drita, nxehtësia dhe rrezatimi: Drita është thelbësore për ndihmën në aktivitete të ndërtimit dhe prodhim betoni. Një ambient i ndriçuar mirë ndihmon në përmirësimin e efikasitetit dhe sigurisë gjatë punës. Nxehtësia ka një ndikim të rëndësishëm në ngurtësimin e betonit. Në temperatura të larta, betoni mund të ngurtësohet më shpejt, duke ndikuar negativisht në cilësinë e tij dhe duke shkaktuar probleme si çarje dhe humbje të forcës. Në bazë të vërtetimeve të diellosjes në katër stacionet metrologjie (Prishtinë, Ferizaj, Prizren, Pejë), ka dal se Kosova ka mesatarisht 2066 orë me diell gjatë vitit ose mesatarisht 5,7 orë në ditë. Vlera më e lartë e diellosjes e regjistruar në Prishtinë është 2140 orë /vit(h/v) dhe më e ulëta në Pejë: 1958 orë /vit (h/v). Gjatë vitit në muajin korrik ka më së shumti diellosje, kurse në dhjetor më së paku

Flora dhe Fauna: Ky aktivitet në aspektin e ndikimeve fizike në florë dhe faunë është minimal. Pasi parashihet ti merr të gjith masat në mos prishjen e flores dhe faunës.

Ndikimet sociale dhe ekonomike: Mund të thuhet se ky aktivitet nuk do të paraqes ndonjë ndikim negativ në komunitetin lokal. Pasi do të ketë vende të reja të punës për banorët e rrethinës. Projekt pritet të ndikoj pozitivisht në ekonominë vendore dhe lokale të komunës së Fushë Kosovës.

4. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së

Bazuar në karakteristikat e bazës së prodhimit të betonit me të gjithë infrastrukturën përcjellëse dhe sipas gjendjes ekzistuese (vendndodhja, madhësia e shtrirjes, ndikimet e mundshme në mjedis etj.), ky projekt është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis i cili është baza kryesore ligjore të cilit ju kemi referuar. Shtojca 2 e këtij ligji, Nenparagrafi 5.8:

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje të tjera relevante, si:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 05/L-025
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për Ndërtim Nr. 04/L-110. Udhëzimet Administrative:
- Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;
- Udhëzim Administrativ (MMPHI) Nr. 02/2022 për kushtet, menyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe trupin ujor.

Pasi që për këtë veprimtari është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikojë për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

5. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË ARSYESHME

Gjatë zgjedhje së lokacionit për ndërtimin e bazave për prodhimin e betoni, janë marrë parasysh alternativa të ndryshme të arsyeshme për të siguruar zgjedhjen e vendndodhjes optimale. Më poshtë do të japim një përshkrim të disa prej alternativave të arsyeshme që janë marrë parasysh gjatë procesit të përzgjedhjes së lokacionit:

- **Zgjedhja e Zonave Industriale:** Zgjedhja e lokacioni është bërë në zonë industriale me infrastrukturë të zhvilluar, ku është e mundur të lidhet lehtësisht me burime të tjera si energjia dhe uji.

Përparësitë:

- Zonat industriale zakonisht ofrojnë rrjete të mira transporti, duke përfshirë rrugë dhe hekurudha, të cilat janë thelbësore për transportin e lëndëve të para dhe shpërndarjen e produkteve.
- Prania e burimeve të ujit afër është kritike për procesin e prodhimit të betonit, duke siguruar një furnizim të vazhdueshëm dhe të besueshëm.
- Një zonë me industri të ngjashme lejon shkëmbimin e përvojave dhe burimeve, duke krijuar mundësi për inovacione dhe optimizim të proceseve.

Mangësitë:

- Aktivitetet industriale të tjera në zonë mund të rrisin ndotjen e ajrit dhe ujit, duke ndikuar në cilësinë e produktit.
- Nëse shumë fabrika të tjera betoni janë të pranishme, kjo mund të sjellë një treg të ngopur, duke e bërë të vështirë mbajtjen e çmimeve konkurruese.

- **Qasja e Mirë:** Lokacioni ofron qasje të shkëlqyer në rrugë dhe infrastrukturë transporti, duke lehtësuar lëvizjen e materialeve dhe produkteve.

Përparësitë:

- Qasja e mirë në rrugë të shpejta dhe hekurudha redukton ndjeshëm kostot për transportin e lëndëve të para dhe shpërndarjen e betonit të gatshëm.
- Mundësia për të lëvizur shpejt dhe me lehtësi mes impiantit dhe tregjeve të ndryshme rrit efikasitetin dhe shërbimin ndaj klientëve.
- Lehtësirat për transport e bëjnë operacionin më të shpejtë dhe më të besueshëm.

Mangësitë:

- Rugët e ngarkuara mund të krijojnë vonesa, veçanërisht gjatë orëve të pikut, duke ndikuar në afatshmërinë e operacioneve.
 - Rritja e aktivitetit industrial në zonë mund të kërkojë investime të mëtejshme në menaxhimin e trafikut për të siguruar sigurinë.
- **Burime Të Tjera:** Lokacioni ofron akses të lehtë në burime të tjera si energjia elektrike dhe ujë, që janë të domosdoshme për funksionimin e impiantit.

Përparësitë:

- Prania e burimeve të energjisë afër mund të rezultojë në kosto më të ulëta operative dhe një furnizim të qëndrueshëm energjie.
- Qasja në burime të rinovueshme ose më efikase mund të ndihmojë në reduktimin e kostove të operacioneve dhe ndikimeve mjedisore.

Mangësitë:

- Çdo problem me furnizimin e energjisë mund të ndikojë në operacionet e fabrikës, duke sjellë vonesa dhe humbje financiare.
- Nëse burimet nuk janë të zhvilluar në mënyrë adekuate, mund të kërkojnë investime të mëdha për të siguruar furnizim të qëndrueshëm.

Duke marrë parasysh këto alternativa të arsyeshme dhe duke vlerësuar tërësisht secilën prej tyre, kompania “Condor” SH.P.K. nuk e ka pasur të vështirë të merr një vendim të informuar për vendndodhjen më të përshtatshme për bazat e prodhimit të betonit. Kompania e ka parë të rëndësishme dhe ka angazhuar ekspertë të cilët kane kryer studime gjithëpërfshirëse të fizibilitetit për të zgjedhur lokacionin që përputhet më mirë me qëllimet dhe vlerat e biznesit të kompanisë “Condor” SH.P.K. Andaj duke i marre parasysh të gjitha alternativat e mësipërme është përzgjedhur lokacioni i bazave për prodhimit të betonit nga kompania “Condor” SH.P.K. e cila ka qasje në rrugën M9, ka energjinë elektrike afër po ashtu ka edhe ujera nëntokësorë në sasi të mjaftueshme e cila ka hapur pusin nëntokësor.

6. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT

Gjendja e mjedisit është si rezultat i zhvillimit të pakontrolluar në sektorët industrialë dhe urbanë, planifikimit joadekuat të pajisjeve industriale dhe urbane, teknologjisë së vjetër industriale, teknologjisë joadekuate në disa departamente industriale të resurseve natyrore, infrastrukturës joadekuate në qytete, shtimi i numrit të automjeteve, ndotja e rrjedhave të ujit për shkak të mungesës së trajtimit të ujërave të zeza, akumulimi i plehrave urbane dhe të ngurta industriale, prerja e pakontrolluar e pyjeve, erozioni i dheut dhe aktivitetet e tjera të njeriut. Mjedisi i komunës së Fushë Kosovës, duhet të mbrohet nga ndotja e madhe që vjen nga ndotësit lokal por edhe nga ndotësit e mëdhenj në komunat fqinje si Termoelektranat dhe Ferronikeli. Mjedisi i komunës së Fushë Kosovës, duhet të mbrohet nga zhvillimi i paplanifikuar, duke respektuar kornizën për zhvillim hapësinor të propozuar me planin zhvillimor, me qëllim të arritjes së shfrytëzimit racional dhe të qëndrueshëm të pasurive të mjedisit. Mjedisi i komunës së Fushë Kosovës, me peisazhin dhe trashëgiminë natyrore paraqet një burim të rëndësishëm për komunën i cili duhet të shfrytëzohet për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionit. Monumentet natyrore e kulturore duhet të trajtohen si trashëgimi kombëtare dhe të shfrytëzohen në mënyrë të qëndrueshme. Vend me potencial turistik paraqet pejsazhi i pyjeve në Sllatinë të Vogël, Harilaq dhe në Bardh të madh. Po ashtu si vend piktoresk mund do jetë në te ardhmen edhe liqeni i peshqve në Henc. (Burimi: Plani lokal i veprimit në mjedis, 2009). Mbrojtja e mjedisit nga ndotja është një prioritet për komunën e Fushë Kosovës duke pasur parasysh shkallën e madhe të ndotjes në vend dhe rajon. Ndotja e ajrit është evidente, dhe përpos trafikut të automjeteve dhe industrisë lokale ndotje të madhe shkaktojnë Termoelektranat në Obiliq si dhe Ferronikeli në Drenas. Po ashtu nga mbetjet e prodhimeve industriale dhe nga mbeturinat ndotet edhe uji në komunën e Fushë Kosovës. Gjatë dhënies së lejeve për objekte zhvillimore ekonomike, në pajtim me rregullat mjedisore, duhet të sigurohen masat parandaluese për ndikimet negative në mjedis siç janë ndotja e ajrit dhe zhurma, vibracionet, rrezatimi, ndotja e ujit dhe ndikimet nga mbeturinat e ngurta. Vlerësimi i ndikimeve në mjedis është i nevojshëm për përmbajtjet prodhuese.

7. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Ndërtimi i bazës së Prodhimit të betonit mund të ketë disa ndikime mjedisore gjatë gjithë ciklit të tij jetësor, nga nxerrja-sjellja e lëndëve të para deri te asgjësimi i mbetjeve. Këto ndikime mund të ndryshojnë në varësi të faktorëve të tillë si vendndodhja e objektit të prodhimit të betonit, lloji i

materialeve të përdorura dhe proceset e prodhimit. Duke u bazuar në analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqesim në këtë rast një analizë më të hollësishme të ndikimeve të mundshme në mjedis duke specifikuar edhe masat zbutëse që do të përdoren për të eliminuar apo për të i minimizuar këto ndikime. Analiza e VNM-së në këtë rast realizohet duke u bazuar në gjendjen në terren, projektin konceptual të bazës së prodhimit të betonit nga “Condor” SH.P.K. Kjo analizë kryhet me qëllim të vlerësimit të ndikimit në mjedis në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit duke mos i cenuar aspektet: e ajrit, ujit, tokës, kimike-fizike (ndikimet në burimet natyrore dhe degradimi fizik i mjedisit), biologjike-ekologjike (ruajtja e biodiversitetit, ndikimi mbi jetën e gjallë dhe biosferë) dhe socio-ekonomike (ndikimet e përkohshme apo të përhershme pozitive apo negative).

7.1. Ndikimet në ajër

Ndikimet në ajër janë një aspekt i rëndësishëm që duhet të shqyrtohet gjatë prodhimit të betonit. Këto ndikime përfshijnë emetimet e ndotësve, efekte të mundshme në cilësinë e ajrit, dhe ndikime shëndetësore për komunitetin. Aktivitetet si përzierja e betonit dhe transporti i materialeve mund të shkaktojnë emetim të pluhurit në ajër. Materialet si çimentoja dhe agregatet (rërë, gurë) shpesh shkaktojnë pluhur gjatë ngarkimit dhe shkarkimit. Pluhuri mund të ndikojë negativisht në cilësinë e ajrit dhe të kontribuojë në formimin e smogut. Ndërsa përgatitet betoni, proceset e djegies dhe përpunimit të materialeve ndonjëherë mund të çojnë në emetimin e gazrave të dëmshëm si dioksidi i karbonit (CO₂) dhe dioksidi i sulfurit (SO₂). Automjetet dhe makineritë që përdoren për transportin e materialeve shpesh lëshojnë gazra ndotës. CO₂ është një gaz me efekt serrë që kontribuon në ngrohjen globale dhe ndryshimet klimaterike. Kimikatet përdoren në ndihmë të proceseve të betonit dhe ndonjëherë mund të shkarkohen në ajër nëse nuk trajtohen siç duhet.

7.2. Ndikimet në tokë

Një bazë për prodhimin e betonit ka potencial për të shkaktuar ndikime të ndryshme në tokë dhe në mjedisin përreth. Këto ndikimi janë:

- Erozioni i Tokës

Aktivitetet e ndërtimit mund të shkaktojnë erozionin, duke humbur shtresën e sipërme pjellore dhe duke ndikuar në sedimentimin e trupave të ujit në afërsi.

- Ngjeshja e Tokës

Ngjeshja e tokës nga makineritë e rënda dhe ndërtimi mund të zvogëlojë hapësirën e poreve, duke reduktuar aftësinë e tokës për të mbajtur ujë dhe për të mbështetur rritjen e bimëve.

- Ndotja e Tokës

Derdhjet aksidentale të materialeve të ndryshme, si çimentoja dhe agregatet, mund të ndotin tokën dhe të ndryshojnë pH-në e saj.

- Ndotja e Ujërave nëntokësore

Shkarkimi i ujit të tepërt ose ujërave të zeza, si dhe rrjedhja e aditivëve kimikë, mund të ndotin ujërat nëntokësore.

- Pluhuri dhe Cilësia e Ajrit

Prodhimi i betonit mund të gjenerojë pluhur që ndikon në cilësinë e ajrit dhe mund të depozitohet në tokë.

- Zhurma dhe Dridhjet

Zhurma dhe dridhjet mund të ndikojnë në shëndetin e tokës dhe sistemet rrënore të bimëve.

- Ndryshimi i Modeleve të Kullimit

Ndërtimi i sipërfaqeve të papërshekueshme mund të ndryshojë modelet natyrore të kullimit dhe të çojë në përmytje.

- Ndikimet nga Mbeturinat

Mbeturinat që krijohen gjatë procesit të ndërtimit dhe mirëmbajtjes mund të ndotin tokën dhe ujërat nëntokësore.

7.3. Ndikimet në ujë

Ndikimet në ujë nga ndërtimi dhe funksionalizimi i një baze për prodhimin e betonit mund të jenë të shumta dhe të ndryshme. Këto ndikime mund të përfshijnë ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ndryshime në cilësinë e ujit, dhe ndikuese të tjera që mund të kenë efekte negative në ekosistemet akvatike dhe në burimet e ujit për përdorim njerëzor. Ja disa nga ndikimet kryesore dhe masat që mund të merren për të menaxhuar këto ndikime:

- Ndotja e Ujërave Sipërfaqësore

Materialet e ndryshme të përdorura në prodhimin e betonit, si çimentoja dhe agregatet, mund të derdhen aksidentalisht në ujërat sipërfaqësorë. Pluhuri i çimentos dhe substancat kimike të tjera mund të shkarkohen në lumenj, liqene ose kanale. Sedimentet e shkaktuara nga erozioni dhe

shpërndarja e materialeve ndotin trupat e ujit, duke zvogëluar dritën që depërton në ujë dhe duke ndikuar në fotosintezën e algave dhe bimëve.

- Ndotja e Ujërave Nëntokësore

Uji i përdorur në proceset e ndërtimit mund të përmbajë kimikate dhe ndotës që rrjedhin në ujërat nëntokësore. Aditivët kimikë dhe substancat e tjera përdoren në prodhimin e betonit dhe mund të ndikojnë në cilësinë e ujërave nëntokësore nëse nuk menaxhohen siç duhet.

- Ndryshimi i Modeleve të Kullimit dhe Rrjedhjeve

Krijimi i sipërfaqeve të ngurta dhe të papërshkueshme, si betonimi i zonave, ndikon në mënyrën se si uji kullon në tokë. Shkurtimi i vegjetacionit dhe ndryshimi i përdorimit të tokës mund të ndryshojnë modelet natyrore të kullimit.

- Përdorimi i Ujit dhe Konsumi

Procesi i prodhimit të betonit kërkon sasi të mëdha uji, që mund të ndikojë në burimet e ujit në afërsi.

- Mbeturinat e Ujit dhe Trajtimi

Mbeturinat e ujit që përmbajnë substanca ndotëse, si nga larja e makinave dhe pajisjeve, mund të shkarkohen në ujërat sipërfaqësore ose nëntokësore.

7.4. Ndikimet në peizazh

Ndikimet në peizazh nga ndërtimi dhe funksionalizimi i një baze për prodhimin e betonit janë të ndjeshme dhe mund të ndryshojnë dukshëm pamjen dhe funksionalitetin e një zone. Këto ndikime mund të përfshijnë ndryshime në formën dhe strukturën e tokës, humbjen e habitatit natyror, dhe ndikime të tjera që mund të dëmtojnë cilësinë estetike dhe ekologjike të zones. Aktivitetet si gërmimi për ndërtimin e objekteve dhe përgatitja e vendit mund të ndryshojnë strukturën e tokës dhe të krijojnë forma të reja që nuk janë në harmoni me peizazhin natyror. Ndërtimi i objekteve industriale, si baza për prodhimin e betonit, mund të krijojë strukturat që ndodhen ndryshe nga peizazhi i mëparshëm. Aktivitetet e ndërtimit shpesh kërkojnë largimin e vegjetacionit natyror, që ndihmon në stabilizimin e tokës dhe ruajtjen e biodiversitetit. Aktivitetet e ndërtimit mund të ndryshojnë strukturën dhe tipologjinë e terrenit, duke krijuar sipërfaqe të papërshkueshme dhe ndryshuar rrjedhjen natyrore të ujit.

7.5. Nikimet në Florë dhe Faunë

Ndikimet në florë dhe faunë nga ndërtimi dhe funksionalizimi i një baze për prodhimin e betonit mund të jenë të ndjeshme dhe ndonjëherë të dëmshme për biodiversitetin dhe ekosistemet natyrore. Aktivitetet e ndërtimit shpesh kërkojnë largimin e vegjetacionit natyror, që është habitat për shumë lloje të florës dhe faunës. Ndërtimi i objekteve industriale, si baza për prodhimin e betonit, mund të shkatërrojë habitatet natyrore dhe të ndikojë në ndarjen e zonave të jetesës për shumë specie. Ndryshimet në peizazh dhe humbja e vegjetacionit mund të ndikojnë në burimet e ushqimit për speciet që jetojnë në zonën e ndikuar. Zhurma dhe aktivitetet e ndërtimit mund të stresojnë kafshët dhe të ndikojnë në sjelljen e tyre, përfshirë zakonet e ushqyerjes dhe riprodhimit. Ndërtimi dhe ndryshimet në përdorimin e tokës mund të ndikojnë në strukturën e ekosistemit dhe në ndërveprimet natyrore ndërmjet florës dhe faunës.

7.6. Ndikimet në vendbanime dhe populate

Gjatë ndërtimit të bazës së prodhimit të betonit si dhe nga zhvillimi i aktivitetit të bazës së betonit, për shkak të pozitës dhe largësisë nga vendbanimet si që e kemi cekur në pjesët e më sipërme, nuk do të ketë nevojë të bëhet ç ‘vendosja e asnjë ndërtese banuese e as ndërtesave tjera ndihmëse. Zhvillimi i veprimtarisë prodhuese në këtë lokacion pak të zhvilluar, ka një rëndësi të veçantë për popullatën e këtij rejonit. Pronari i kompanisë për të zhvilluar veprimtarin e vet ka planifikuar që të punësuarit të jenë kryesisht nga popullata vendase. Prandaj si u cek më lartë në aspektin social do të ketë ndikime pozitive. Largësia e shtëpive nga baza e betonit është mbi 435.59metra.

7.7. Ndikimet nga zhurma

Funksionimi i makinerive të rënda, dërrmuesve dhe pajisjeve të përfshira në prodhimin e betonit mund të gjenerojë nivele të larta zhurme. Kjo zhurmë mund të prishë paqen dhe qetësinë e komuniteteve përreth, duke ndikuar në cilësinë e jetës së banorëve, modelet e gjumit dhe mirëqenien e përgjithshme. Me shfrytëzimin e pajimeve prodhuese në bazë të standardeve të caktuara me ligje dhe rregulla të aplikueshme maksimumi i zhurmës në burim është 90 dB. Niveli i zhurmës për zonat e banuara në bazë të standardeve ndërkombëtare është i caktuar 50 dB për kohën gjatë ditës, kurse gjatë natës niveli i zhurmës duhet të jetë max. 45 dB. Në vijim po e paraqesim në formë tabelore nivelin e zhurmës në varshmëri nga distanca.

Table 1. Tabela e vlerave të lejuara të zhurmës

Zhurma	Distanca e lejuar (metra)			
	10	50	100	500
90 db – Niveli i pajisjeve modele	59	45	39	25

Në bazë të vlerave të paraqitura në tabelë dhe duke pasur parasysh distancën e ndërtesave të banimit si dhe kapacitetin prodhues të pajimeve dhe numrin e mjeteve transportuese që nevojiten për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit, si dhe duke pasur parasysh se punohet vetëm ditën, mund të konkludojm se baza e betonit për prodhimin e betonit nuk ka ndikime negative të mëdha në njerëzit që banojnë dhe veprojnë në rrethin të betonierës.

7.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Pasi që aktiviteti i bazës për prodhimin e betonit dhe pajisjeve tjera përcjellëse janë mirë të projektuara, të vendosura dhe të monitoruara nga ekspertët e lamive përkatëse dhe njëherit kur dihet se brenda veprimtarisë prodhuese nuk kemi të bëjmë me materie të rrezikshme për mjedisin, aksidente mjedisore të mëdha nuk mund të ndodhin. Aksidentet të cilat mund të ndodhin, mund të jenë të natyrës së ndryshme dhe mund të ndodhin në çdo kohë gjatë realizimit të procesit teknologjik si:

- Nga rrjedhjet e ndryshme të lëndëve djegëse dhe lubrifikuese.
- Nga mekanizmi punues (mundësia e ndezjes).
- Nga mekanizmi punues mundësia e pëlcitjes së gypave hidraulik.
- Nga aksidentet e mundshme në komunikacion gjatë transportit të agregatit, çimentos dhe betonit.
- Nga aksidentet e mundshme në komunikacion gjatë kyçjes së automjeteve transportues nga baza e betonit në rrugën regjionale

7.9. Erozioni

Erozioni mund të shkaktohet si nga thatesirat me temeperatura të larta ku kemi qarje të tokës e po ashtu edhe nga vershimet ku kemi grryerje të tokës. Dridhjet të tokës, tërmete me intensitet të lartë ka pasur por pa pasoja në njerëz dhe dëme materiale. Këto dridhje kanë shkaktuar vetëm shqetësim.

8. PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS

Pasojat e mundeshe që mund të ndodhin me ndërtimin e Bazës së Prodhimit të betonit nga kompania "Condor" SH.P.K janë:

Ndikimet në Ajër: Prodhimi i betonit shpesh krijon pluhur, veçanërisht gjatë përzierjes dhe transportit të materialeve si çimento, agregate, dhe aditivë. Ky pluhur mund të përmbajë grimca të imta që ndotin ajrin.

Ndikimet në Tokë: Aktivitetet e ndërtimit, përfshirë përdorimin e makinerive të rënda, mund të shkaktojnë ngjeshjen e tokës, e cila ndikon në aftësinë e saj për të mbajtur ujë dhe për të mbështetur rritjen e bimëve.

Ndikimet në Ujërat Nëntokësore dhe Sipërfaqësorë: Shkarkimet e ujërave të përdorura gjatë procesit të prodhimit mund të ndotin burimet e ujit nëntokësorë dhe sipërfaqësorë.

Ndikimet në Peizazh dhe Ekosisteme: Aktivitetet e ndërtimit mund të ndryshojnë peizazhin natyror dhe të ndikojnë në pamjen vizuale të zones, ndërhyrjet në habitatet natyrore mund të ndikojnë në florën dhe faunën lokale, duke ndikuar në biodiversitetin e zonës.

Ndikimet në Vendbanime dhe Popullatë: Aktivitetet e ndërtimit dhe operacionet e bazës mund të krijojnë zhurmë dhe ndotje që ndikon në cilësinë e jetesës për banorët e zonës.

Betonjerka "Condor" SH.P.K, si çdo bazë tjetër e prodhimit të betonit, mund të ketë ndikime të shumta në mjedis, duke prekur ajrin, tokën, ujërat, peizazhin dhe vendbanimet përreth. Për të menaxhuar këto ndikime dhe për të minimizuar efektet negative, është e rëndësishme të zbatohet një qasje e qëndrueshme që përfshin monitorimin e vazhdueshëm, implementimin e masave të zbutjes dhe angazhimin e komunitetit për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm dhe për të mbrojtur ambientin dhe shëndetin publik.

9. PËRSHKRIMI I METODAVE PËR VLERSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE

Metodat për vlerësimin e pasojave mjedisore janë të rëndësishme për menaxhimin dhe minimizimin e ndikimeve negative që mund të kenë projektet dhe aktivitetet në mjedis. Për të siguruar që një sistem menaxhimi mjedisor të jetë efektiv dhe të përmbushë standardet, përdoren disa metoda të caktuara që ndihmojnë në vlerësimin dhe monitorimin e ndikimeve. Ja disa nga këto metoda të përdorura për vlerësimin e pasojave mjedisore:

➤ Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore

Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore është një metodë që shqyrton ndikimet e mundshme të një projekti në mjedis para se të fillojë ai. Ky proces përfshin:

- **Studimi dhe Analiza:** Identifikimi i ndikimeve potenciale dhe vlerësimi i efekteve të mundshme mbi ajrin, tokën, ujin, florën dhe faunën.
- **Raportimi:** Krijimi i një raporti të detajuar që përmbledh gjetjet dhe rekomandimet për masat e zbutjes.
- **Konsultimi:** Angazhimi i palëve të interesuara dhe publikimit të raportit për të marrë feedback dhe për të siguruar transparencë.

➤ Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit

Një Sistem i Menaxhimit të Mjedisit është një metodë sistematike për të menaxhuar dhe kontrolluar ndikimet mjedisore të një organizate. Ky sistem përfshin:

- **Planifikimi:** Identifikimi i ndikimeve dhe krijimi i planeve për të përmbushur kërkesat mjedisore.
- **Implementimi:** Zbatimi i politikave dhe procedurave për të menaxhuar ndikimet mjedisore.
- **Kontrolli dhe Monitorimi:** Monitorimi i performancës mjedisore dhe auditimi për të siguruar përputhshmërinë me standardet dhe rregulloret.
- **Përmirësimi:** Rishikimi dhe përmirësimi i procedurave për të përmirësuar performancën mjedisore.

➤ Analiza e Ciklit të Jetës

Analiza e Ciklit të Jetës shqyrton ndikimet mjedisore të një produkti gjatë të gjithë ciklit të tij, nga ekstraktimi i lëndëve të para deri në përdorim dhe asgjësim. Ky proces përfshin:

- **Hulumtimi i Ndikimeve:** Vlerësimi i ndikimeve gjatë fazave të ndryshme të ciklit të jetës së produktit.

- **Krahasimi:** Krahasimi i ndikimeve të ndryshme për të identifikuar mundësitë për përmirësim.
- **Raportimi:** Krijimi i një raporti që tregon ndikimet dhe rekomandimet për përmirësim.

➤ Studimi i Ndikimeve Ambientale dhe Shëndetësore

Studimi i Ndikimeve Ambientale dhe Shëndetësore shqyrton ndikimet e një projekti jo vetëm në mjedis, por edhe në shëndetin e njeriut. Ky studim përfshin:

- **Analiza e Rrezikut për Shëndetin:** Vlerësimi i rreziqeve të mundshme për shëndetin nga ndotja dhe ekspozimi ndaj substancave të dëmshme.
- **Studimi i Efekteve në Komunitet:** Analiza e ndikimeve në cilësinë e jetesës dhe shëndetin e komunitetit përreth.

➤ Analiza e Rrezikut Ambientale

Analiza e Rrezikut Ambientale fokusohet në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve që një projekt mund të sjellë për mjedisin. Ky proces përfshin:

- **Identifikimi i Rreziqeve:** Përcaktimi i mundësive dhe probabilitetit të ndodhisë së incidenteve ndotëse.
- **Vlerësimi i Pasojave:** Analiza e pasojave për ambientin në rast të ndodhisë së këtyre incidenteve.

10. PËRSHKRIMI I MASAVE

Me poshtë do ti përshkruajmë të gjitha masat që duhet marr kompania për t'ju shmangur, parandaluar, zvogëluar apo mënjeluar pasojat negative në Mjedis:

10.1. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Për të mbrojtur cilësinë e ajrit dhe për të zvogëluar ndotjen në impiantet e prodhimit të betonit, është e rëndësishme të implementohen masa të ndryshme dhe praktika më të mira. Më poshtë janë disa masa dhe strategji të rekomanduara:

Kontrolli i Pluhurit: Duhet të bëhet instalimi i sisteme efikase të grumbullimit të pluhurit, si filtra dhe kolektorë pluhuri, për të kapur pluhurin gjatë operacioneve të trajtimit dhe përzierjes së materialeve. Përdorni mbyllje ose mbulesa për të minimizuar shpërndarjen e pluhurit nga trajtimi,

grumbullimi dhe përzierja e materialeve. Aplikoni sistemet e spërkatjes së ujit për të shtypur pluhurin që ngrihet në ajër gjatë operacioneve.

Trajtimi dhe Ruajtja e Materialeve: Të ruhen lëndët e para në zona të mbyllura ose të mbuluara për të parandaluar shpërndarjen e pluhurit nga era. Të përdoren transportues ose kanale të mbyllura për të transferuar materialet, duke zvogëluar rrezikun e derdhjes dhe shpërndarjes së pluhurit.

Pajisjet e Kontrollit të Emetimeve: Të sigurohen që pajisjet e kontrollit të ndotjes të jenë të instaluar dhe të mirëmbahen në mënyrë të rregullt për të kapur dhe hequr grimcat dhe emetimet. Të bëhet inspektimin dhe pastrimin e rregullt të filtra dhe media filtrave në sistemet e grumbullimit të pluhurit.

Emetimet e Automjeteve: Siguroni që kamionët dhe automjetet e përdorura për transportimin e materialeve dhe betonit të jenë të mirëmbajtur mirë dhe të përmbushin standardet e emetimeve.

Trajnimi dhe Ndërgjegjësimi i Punonjësve: Siguroni trajnimin e punonjësve mbi praktikatat më të mira për minimizimin e ndotjes së ajrit dhe përdorimin e pajisjeve të kontrollit të ndotjes. Ndihmoni punonjësit të raportojnë çdo burim të mundshëm ndotjeje ose mospërputhjeje.

Materialet dhe Teknologjia Alternative: Adoptoni materiale ose procese alternative që gjenerojnë më pak emetime, si përdorimi i materialeve të ricikluara ose shtesave të veçanta. Investoni në teknologji të avancuar për të reduktuar emetimet dhe për të përmirësuar efikasitetin e procesit të prodhimit.

Praktikat e Qëndrueshme: Implementoni praktikatat e riciklimit të aggregateve dhe reduktimit të mbetjeve për të zvogëluar ndikimin mjedisor të prodhimit të betonit. Përshtatni dizajnin e përzierjes së betonit për të zvogëluar konsumimin e materialeve dhe për të minimizuar mbeturinat.

Monitorimi dhe Përmirësimi i Vazhdueshëm: Kryeni monitorime të rregullta të cilësisë së ajrit në terren dhe në zonat përreth për të vlerësuar ndikimin e operacioneve dhe për të identifikuar burimet e ndotjes. Implementoni ndryshime dhe përmirësime të vazhdueshme në proceset dhe teknologjitë për të reduktuar emetimet dhe për të përmirësuar performancën mjedisore.

10.2. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë dhe në tokë

Për të zvogëluar ndikimet negative në ujë dhe në tokë nga impiantet e prodhimit të betonit, është e rëndësishme të zbatohen një sërë masash dhe praktikash të menaxhimit të mjedisit. Monitoronimi

dhe kontrollimi i përmbajtjeve dhe shkarkimet në ujëra për të siguruar se ato përmbushin standardet dhe rregullat e ndotjes. Implementimi i masave për të ndaluar shkarkimet aksidentale nga sistemet e ndihmës që mund të ndodhin për shkak të defekteve në pajisje ose procese. Zbatimi i praktikave për të mbrojtur tokën nga erozioni, si mbulimi i sipërfaqeve të zbuluara me materiale mbrojtëse ose mbulime vegetative për të parandaluar rrjedhjen e ujit. Përdorni teknikë të avancuara dhe makineri që minimizojnë ngjeshjen e tokës dhe ndikimet në strukturën e saj. Implementoni një sistem të efektshëm për menaxhimin e mbeturinave, duke përfshirë riciklimin e materialeve dhe trajtimin e mbetjeve të ndotura për të parandaluar ndotjen e tokës. Siguroni që materialet dhe pajisjet të ruhen në mënyrë që të parandaloni ndotjen e tokës nga derdhjet aksidentale. Ruani dhe mbani vegetacionin ekzistues sa më shumë që të jetë e mundur për të ndihmuar në parandalimin e erozionit dhe për të mbajtur stabilitetin e tokës. Kryeni pastrim të rregullt të tokës për të hequr mbeturinat dhe ndotësit e mundshëm që mund të ndikojnë në cilësinë e tokës dhe shëndetin e ekosistemeve.

10.3. Masat për mbrojtje nga zhurma

Të bëhet matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtjen nga zhurma. Matjet duhet bërë në afërsi të objekteve të banimit. Për vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti krahasojmë me vlerat e lejuara me standarde për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit. Në raste se zhurma e mesit nga matjet tejkalon at të lejuarën atëherë duhet të merren të gjitha masat që niveli i zhurmës të bihet në nivelin e lejuar sipas rregullave në fuqi. Në varshmëri nga fazat e procesit të punës duhet edhe të punësuarit në ato vende të punës të përdorin mjetet kundër zhurmës.

10.4. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë

Prodhimi i betonit mund të ketë ndikime të rëndësishme në florë dhe faunë. Për të zbutur këto ndikime, është thelbësore të zbatohen një sërë masash dhe praktikash më të mira. Me zbatimin e masave të ajrit, ujit, tokës dhe zhurmës mund të kemi një florë dhe faunë të mirë në afërsi të bazës së prodhimit të betonit. Sa i përket peizazhit do të ndryshoj sepse është ngritur baza me të gjitha elementet e sajë por duhet mbjelle druje dhe pisha për arsye të përmirësimit të ambientit dhe natyrës.

10.5. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë

Baza për prodhimin e betonit mund të ketë ndikime të rëndësishme në vendbanimet dhe popullatat, duke përfshirë ndotjen e ajrit dhe zhurmës, bllokimin e trafikut dhe shqetësime të tjera mjedisore dhe sociale. Për të ruajtur popullatën dhe vendbanimet kompania do të ndërmarr të gjitha masat për mbrojtjen e ajrit, ujit, tokës, zhurmës që të mos ndikojnë negativisht në popullatë edhe pse nuk ka shtëpi afër.

10.6. Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore

Për mbrojtjen ndaj rreziqeve dhe aksidenteve mjedisore duhet marrur Masat për mbrojtjen nga rreziqet aksidenciale. Duhet të bëhet plani i intervenimit për raste të aksidenteve mjedisore. Duhet të bëhet plani për mbrojtje nga zjarri. Duhet pjesa e oborrit të betonierës të thuret me tel gjembor. Të merren të gjitha masat për evitimin e derdhjes së derivateve të naftës dhe vajit nga makinat transportuese dhe ngarkuese si dhe pajimet tjera. Të merren të gjitha masat e sigurisë për kyçjen e automjeteve transportuese në rrugën lokale dhe atë magjistrale pa penguar komunikacionin. Të merren të gjitha masat e sigurisë komfor ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mjedisit të punës.

10.7. Menaxhimi i mbeturinave

Gjatë operimit të bazës së prodhimit të betonit krijohen mbeturina po thuajë se fare pakë gjatë procesit teknologjik të prodhimit dhe atë në mbetje të ambalazhues së letrës, qeseve dhe mbeturina nga inertet, pra kryesisht mbeturina të riciklueshme si dhe mbeturinat të cilat i bënë personeli gjatë procesit të punës në Bazën e betonit. Prandaj këto mbeturina duhet të adresohen në mënyrë adekuate, në mënyrë që ato mos të jenë faktorë ndotje në mjedis dhe të jenë në harmoni me praktikatat e mira mjedisore dhe ligjet vendore në fuqi. Për largimin e këtyre mbeturinave kompania do të bëjë marrëveshje me kompaninë e licencuar për menaxhimin e mbeturinave nga Komuna e Fushë Kosovës.

Table 2. Paraqitja e mbeturinave sipas katalogut shtretëror

Mbeturinat sipas katalogut shtretëror			
Numri sipas katalogut shtretëror të mbeturinave	Emri i Mbeturinës	Shkalla e rrezikshmërisë	Lloji i planifikuar për deponimi të mbeturinave

20 01 01	Letër dhe karton	Jo të rrezikshme	Kontenjer për mbeturina
20 03 01	Mbeturina të përziera komunale	Jo të rrezikshme	Kontenjer për mbeturina
20 01 39	Plastika	Jo të rrezikshme	Kontenjer për mbeturina

Për mbetje e mundshme të këtij aktiviteti, zgjidhja është si në vijim:

- Mbeturinat ditore nga personeli do të grumbullohen dhe do të adresohen në mënyrë adekuate në kontejnerët e ndërmarrjes komunale për mbeturina,
- Ndërsa mbeturinat tjera eventuale nëse krijohen do të trajtohen komfor legjislacionit adekuat për menaxhim me mbeturina.

11. PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE

Sa i përket aksidenteve apo katastrofave të mëdha që lidhen me Bazën për prodhimin e Betonit nga kompania “Condor” SH.P.K., nuk kemi fare rrezik, rrezik minimal mund të kemi vetëm nga energjia elektrike e cila mund të djeg ndonjë makine apo ndonjë instalim elektrik, por edhe për këtë kompania i ka marrur të gjitha masat duke siguruar aparate për fikjen e zjarrit dhe hidrantë të brendshme për fikjen e zjarrit.

12. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi – Shihet qarte se ky aktivitet nuk paraqet trysni mjedisore, monitorimi i detyrueshëm dhe permanent i treguesve mjedisor janë të domosdoshëm. Produktet dhe ndikimet në mjedis do të kontrollohen në mënyrë të rregullt dhe për çdo rast duhen të merren masat e nevojshme komfor ligjeve dhe të njoftohen organet kompetente.

Raportimi - do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxheri i kompanisë, gjegjësisht nga ekspertet e kompanisë brenda dhe jashtë sajë. Në raport, eventualisht do të përfshihen të dhënat për monitorimin e të gjitha parametrave të cilët do të jenë kërkuar në Pëlqimin Mjedisor (lejen mjedisore e cila lëshohet pasi të pajisemi me Pëlqim Mjedisor nga MMPHI).

13. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHËSHME

Duke analizuar studimin e bërë për identifikimin e ndikimeve të mundshme, masave për parandalimin e ndikimeve, intervistave e opinioneve, si dhe duke iu referuar dokumenteve ekzistuese dhe atyre të planifikuara mund të arrijmë në një përfundim si në vijim: Baza për prodhimin e betonit nga kompania “Condor” SH.P.K., ka për qëllim prodhimin e betonit të freskët si dhe furnizimin e shpejte dhe në kohë, për nevojat e kompanisë si dhe për nevojat e qytetareve në rajonin e komunës së Fushë Kosovës, e që është në interes;

- Të vet investitorit për të përmirësuar kushtet dhe efikasitetin e punës,
- Në interes të komunës sepse do të ketë një ndikim në rritjen e punësimit dhe të hyrave në komunë, dhe
- Në interes të banorëve të tjerë lokal, sepse do të ofrohen mundësi e një ambienti me te menaxhuar, mundësi punësimi, si dhe do te furnizohen me beton me cilësi të larte dhe të sigurt.

Në rast sipas përfundimit, Baza për prodhimin e betonit nga kompania “Condor” SH.P.K., mirëmbahet në mënyrë profesionale dhe me standarde siç parashihet të mirëmbahet dhe me respektimin e plotë të masave të dhëna në këtë raport, si dhe me bashkëpunimin e plotë me autoritetet, kjo Bazë për prodhim të betonit konsiderohet krejtësisht e pranueshëm si në aspektin mjedisor, po ashtu edhe në atë social dhe ekonomik.

- Duke u bazuar në natyrën e aktivitetit e bazës se prodhimit të betonit, vendodhjen, kapacitetin dhe intensitetin e veprimeve, mund të konstatohet se ndikimet në shëndetin e njeriut dhe në mjedisin lokal janë minimale dhe tërësisht të kontrollueshme.

Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme për raport të VNM-së dhe i propozojmë institucionit kompetent përkatësisht Ministrisë se Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturë (MMPHI), për dhënien e mendimit pozitiv për Pëlqim Mjedisor sipas kërkesës së investitorit - aplikuesit “Condor” SH.P.K me pronar Bekim Thaqi.

14. ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT NË FORMË TABELARE

TABELA E KOST – BENEFITIT TË INVESTIMIT NË BAZEN E BETONIT NGA KOMPANIA “CONDOR” SH.P.K		
Nr.	Emri	Çmimi (€)
1.	Bunkerët pranues të rërës dhe zhavorrit	27,000.00 €
2.	Dozatorët Pneumatik	10,000.00 €
3.	Peshoret automatike për matjen e materialit guror dhe për çimento,	8,000.00 €
4.	Peshoret automatike për matjen e materialit guror dhe për çimento	12,000.00 €
5.	Pompat dhe furnizimi me ujë	3,000.00 €
6.	Shiritat transportues furnizues	14,000.00 €
7.	Perziresit e betonit – mikseret	35,000.00 €
8.	Silaset e çimentos me filtraventilues	45,000.00 €
9.	Transportuesit me Vidhë	8,000.00 €
10.	Kabina Komanduese	10,000.00 €
11.	Kompresori për furnizim me ajër për pajisjet pneumatike	3,000.00 €
Shuma totale investive		175,000.00 €

“CONDOR” SH.P.K.

15. LITERATURA E PËRDORUR

Lista e bibliografisë (referencave) së burimeve të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e përfshira në raport:

[1] [*Të dhënat nga investitori*](#)

[2] [*Plani-Zhvillimor-Komunal-në-Fushë-Kosovë-2013-2023.pdf \(rks-gov.net\)*](#)

[3] [*PLVM-Fush-kosova1:Layout 1.qxd \(unhabitat-kosovo.org\)*](#)

[4] [*Kërko dhe paraqit - KGP \(rks-gov.net\)*](#)

[5] [*OpenStreetMap*](#)

[6] [*LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS \(rks-gov.net\)*](#)